



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, 13/06/2025

Në mbështetje të nenit 8, 10, dhe 15 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në shtojcën 1 pika 15 të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Programin për Zhvillim Rajonal 2025 – 2027 Masa 1, Planin e Punës së MZHR-së për vitin 2025, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 95 dt. 26.03.2025 për Aprovimin e Udhëzuesit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për realizimin e Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2025 dhe Raportit të Komisionit vlerësues me nr.535 datë 10.06.2025.

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
“Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik”

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Zhvillimit Rajonal e përfaqësuar nga Ministri i MZHR-së (në tekstin e mëtejme MZHR) dhe,
2. Komuna e Podujevës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit **“Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik”** si dhe përcaktimi i obligimeve të MZHR -së dhe Komunës së Podujevës , për realizimin e këtij projekti.

Neni 2
Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti **“Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik”** ka vlerën paralogaritare prej 350,000.00€,
2. MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2025, financon këtë projekt në shumën prej 50,000.00€.
3. Komuna e Podujevës nga buxheti i saj vjetor i vitit 2025, financon këtë projekt në shumën prej 50,000.00€
4. MZHR nga buxheti i saj vjetor i vitit 2026, financon këtë projekt në shumën prej 200,000.00€
5. Komuna e Podujevës nga buxheti i saj vjetor i vitit 2026, financon këtë projekt në shumën prej 50,000.00€

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

1. MZHR i zoton mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat për projektin **“Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik”** bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, gjithsesi deri në shpenzimin e mjeteve të zotuara të buxhetit të MZHR-së pagesat kryhen nga këto mjete e tek pastaj fillojnë pagesat e bashkëfinancim të projektit nga Komuna.
3. MZHR do të monitoroj projektin gjatë gjithë fazave të implementimit dhe mund të angazhojë gjithashtu kompani të jashtme për të monitoruar realizimin e tij. DPKZHR do të kordinoj bashkëpunimin mes Menaxherit të projektit ose Organit Mbikqyrës të caktuar nga Kryetari i Komunës pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së paralogaritur të projektit dhe një kopje ta dërgoj në MZHR.
2. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.
3. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, komuna duhet t'i filloj brenda 30 dite kalendarike pas marrjes së konfirmimit për zotim të mjeteve nga MZHR në të kundërtën MZHR në mënyrë të një anshme mund të ndërpres marrëveshjen.
4. Komuna me rastin e formimit të Komisionit për procedurat e prokurimit dhe tenderimit duhet të kërkoj nga MZHR një anëtar të komisionit për vlerësimin e tenderëve. Në rast se MZHR nuk njoftohet me kohë për përfshirje në procesin e prokurimit atëherë përgjegjësia kalon komplet tek komuna dhe MZHR do të evidentoj si rast edhe mund ta penalizoj për financime në të ardhmen këtë Komunë.
5. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MZHR së bashku me informatat për biznesin me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).
6. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

8. Komuna obligohet që të njoftoj MZHR-në për çdo propozim ndryshim eventuale të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga MZHR (për pjesën e financuar nga MZHR).
9. Komuna duhet të vendosë tabela informuese/Pano me dimensione 2m x 1.5m në vend punishte me përshkrimin si në vijim:
 - a) Emri i projektit,
 - b) Investitorët (Ministria e Zhvillimit Rajonal me logon e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komuna),
 - c) Emri i operatorit ekonomik dhe
 - d) Kohëzgjatja e punimeve sipas Kontratës së nënshkruar në mes të Komunës dhe OE.
10. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që shumatat e projektit të përfundojnë brenda viteve buxhetore 2025/2026. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
11. Komuna është e obliguar të raportojë mbi progresin e projekteve të MZHR-ja dhe të dorëzojë një raport final në fund të projektit. Pas dorëzimit të raportit narrativ të implementimit të projektit, komunat duhet të fillojnë procedurat për pranimin teknik të projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera deri në shumën e financimit nga ana e MZHR -së, Komuna obligohet që të kompletoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
 - 1.2 Vendimi për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimin nga ana e Komunës;
 - 1.3 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimin mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situationet);
 - 1.4 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga MZHR;
 - 1.5 Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
 - 1.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6 Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).
3. Komuna pas regjistrimit të pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK), menjëherë njofton MZHR me Dokumentacionin përkatës për bartje të pasurisë (Raporti i pranimi Teknik - certifikata e përkohëshme e pranimi teknik)

Neni 7 Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me propozim të Departamentit për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal dhe me pëlqimin paraprak të Ministrit të MZHR-së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.
3. Në rastet kur paraqiten konteste të çfarëdo natyre përgjegjësia mbetet mbi Komunën, rrjedhimisht MZHR mbanë të drejtën e ndërprerjes së kësaj Marrëveshje me automatizëm dhe mjetet e ndara për këtë projekt ti ridestinoj për projekte të tjera nga thirrja e këtij viti.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët zgjedhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 9 Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MZHR -së dhe Kryetari i Komunës.
2. Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Fikrim Damka
Ministër në detyrë i MZHR -së

P. P. 

Shpejtim Bulliqi
Kryetar i Komunës së Podujevës

